

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
Nr 16990/1 vendimit

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me daten 17/05/2003 Une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane B. Ume /, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuara "**Gramo**" shpk me ortak te saj z. Kapllan Gramo dhe z. Eduart Gramo, per depozotimin e dokumentave per ndryshime ne statutin e shoqerise shoqerise,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.16990 date 18.2.1997 eshte themeluar shoqeria "**Gramo**" shpk.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" shoqeria me vendimin nr.1 date 02.04..2003 ka vendosur :

- 1. Transferimin e pjesshem te kuotave te kapitalit me ane te shitjes , duke ja kaluar z. Llambi Pire 25% dhe Z.Alfred Gramo 25% ,duke u bere keta te fundit, bashkeortake me kuota te barabarta nga 25% seicili ne shoqerine "GRAMO" shpk.**
- 2. Miratimin e emerimit te administratorit te ri te shoqerise z. Eduart Gramo.**

*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare Tirane me objekt: **1. Transferimin e pjesshem te kuotave te kapitalit me ane te shitjes , duke ja kaluar z. Llambi Pire 25% dhe Z.Alfred Gramo 25% ,duke u bere keta te fundit, bashkeortake me kuota te barabarta nga 25% seicili ne shoqerine "GRAMO" shpk.**
2. Miratimin e emerimit te administratorit te ri te shoqerise z. Eduart Gramo.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993

V E N D O S A

*Pranimin e kerkeses.

*Depozitimin e kerkeses dhe dokumentave te paraqitura nga shoqeria "**Gramo**" shpk Tirane duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kollonen 3, kollona 4/c e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E
B. Ume
Ume

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 16990/2

V E N D I M
I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 28 .05.2003, une gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Kapllan Gramo cili kerkon depozitim e VENDIMIT TE Asamblese se Ortakeve, date 20.05.2003 per shtese objekti ne skeden perkatese te shoqerise "GRAMO" shpk dhe ;

K O N S T A T O V A ;

Me vendimin nr.16990, date 18.02.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " gramo " shpk me ortak Kapllan Gramo dhe Eduart Gramo, me administrator Kapllan Gramo , me objekt veprimtarie ne fushen -shfrytezimit dhe perpunumit te lendeve drusore, mbarshtrim dhe permisim te pyjeve etj.

Me vendimin nr.2 dt.20.05.2003 te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie eshte vendosur te shtoje objektin edhe ne fushen e A. Studim e projektme te punimeve pyjore.

1.Per hartimin e planeve te manaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjyetise sportive e turistike e kullotave.

2.Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve .

3.Hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve per hartimin e projekteve te manaxhimit te pellgjeve e ujembledhes.

4.Per studimin e mbritshmerise dhe ndertimin e rrugeve pyjore.

5.Per studimin fitopatologjik-entomologjike dhe zjarreve ne pyje

Per studimin e manaxhimit e perdorimit te teritorit. .

Per studimin e rezervave gjenetike, pyjore dhe biodiversitetin.

Zbatimin e te punimeve pyjore.

Per pyllezimet (fidanishtet, grumbullimin e trajtimit e farerave pyjore, punime pregatitore e mbjellje fidanesh).

Per permiresimin e pyjeve(licungime e trajtim pyjesh me prerje

Per hartimin e planeve te manaxhimit te pujeve, flores spontane, gjyetise sportive e turistike dhe kullotave.

Per hartimin e projekteve te pyllezimit.

Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve .

b e qendrueshem te pyjeve , sistemime malore, ndertimin e rrugeve pyjore, grumbullimin dhe vjeljen e qendrueshme te prodhimeve pyjore jo drusore dhe flores spontane, mjeksore e tanifere.

Per ushtrimin e gjuetise sportive turistike te faunes se eger per mbrojtjen nga semundjet demtuesit dhe zjarret.

Perpunime ne kullota, livadhe, dhe ndertimin e meremettimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota dhe livadhe.

Kerkesa e tij per t'u bere ndryshimet perkatese ne Skeden e kesaj shoqerie ne Zyren e Regjistrimit tregtar eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te ligjit 7667, date 28.1.1993 per Regjistrimin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te ;

V E N D O S A ;

Pranimin e kerkeses per depozitimin e vendimit nr.1, date 20.05.2003, te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "gramo" SH.P.K

Urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar per te bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen e 2,4 e 5 , numer rendor 3 si dhe te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

Magdalena Doff
Doff

URDHER REGJISTRIMI

Me

1

16990

2

"GRAMO" SH. P. K.

a)

Ersekë

b)

100.000 Lekë

c)

Sifrytezim dhe përp. të Cimites dhe sone, pka
dhem dhe sifry me shumice "kapite" dhe
Jan. chsp. me shprehje dhe sifry

d)

1- Kapelon Gramo, 2- Cimites Gramo

3

Kapela in Gramo, Avni
Aubheromit, dhe 182, Avni in Ersekë.

4. Statuti nenshkruar me date 19.2.1997

Statuti

Flete 10

Njoftime:

- a) shoqeria
- b) dhoma e tregetise
- c) organi perkates financiar
- d) zyres se statistikave

Publikime:

GJYQTARE

Druidha Capo

[Signature]



AKT THEMELUES KONTRATE

I SHOQERISE TREGETARE PRIVATE "GRAMO" SH.P.K.

1. **Kapllan Gramo**, i biri i Muharremit, Datelindja 1952, lindur e banues ne Erseke.
2. **Eduart Gramo**, i biri i Shkelqimit, Dtl. 1967, lindur e banues ne Erseke.

Mbeshtetur ne nenin 251, shkronja "c", te Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te vepritarise private dhe privatizimit", krijojme shoqerine tregtare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "GRAMO" dhe lidhim kete kontrate si vijon:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "GRAMO" sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues (kontrate) dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

VEND-QENDRIMI I SHOQERISE

NENI 2

Vend-qendrimi i shoqerise tregtare private "GRAMO" sh.p.k. do te jete ne Erseke.

Shoqeria do te hape edhe vend-qendrim te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi, ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

1. Shfrytezim dhe perpunim te lendes drusore, mbareshtim dhe permiresime te pyjeve.
2. Prodhimin dhe shitjen me shumice e pakice te produkteve dyta te pyllit, si thupra, reshire etj.
3. Sistemimin e pellgjeve, ndertimin e ujembledhesave, sistemim kullota dhe livadhe.
4. Tregetim me shumice e pakice dhe import-eksport te:
 - Mallra industriale, ushqimore, elektro-shtepiake, konfeksione
 - Mallra bujqesore e blegtorale, bime medicinale-mjekesore etj.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhimi, tregetimi, sherbimi dhe perpunimi dhe bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar dhe mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregetare private "**GRAMO**" sh.p.k. do te jete 100.000 leke dhe do te perbehet nga kuotat e ortakeve themelues te shoqerise.

1. **Kapllan Gramo**..... 50 %
2. **Eduart Gramo**..... 50 %

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te Asamblese se ortakeve.

Kuotat e pjesemarresve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nen-shkrueshem.

NENI 7

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj dhe te mos demtojne interesat e personave te tjere e te shoqerise.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, caktuar nga ortakët themelues te shoqerise, z.**Kapllan Gramo**.

Ortakët e shoqerise kane te drejta e detyrime te barabarta ndaj shoqerise dhe ligjeve.

NENI 9

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise, ne proporcion me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar.



NENI 10

Ortakët kanë të drejtë të emerojnë edhe administratore të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë.

Ata kanë të drejtë të caktojnë financiar, likuidator për problemin e shoqërisë, si edhe të pajtojnë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiarë tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konflikti që mund të lindin midis paleve do të gjykohen në Gjykatën e Rrethit Erseke, sipas statutit të shoqërisë, kontratës së lidhur me palet dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar.

NENI 12

Shoqëria ka vullenë e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plote të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Mbi krijimin e shoqërive tregëtare".

NENI 14

Ky akt themelimi (kontrata) do të hyjë në fuqi pas marrjes së lejes nga organet kompetente.

NENI 15

Akti i themelimit (kontrata), u përplua në disa kopje për t'iu shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregëtare private "GRAMO" sh.p.k.

Akti i themelimit (kontrata) nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

"GRAMO" sh.p.k.

Kapllan Gramo

Eduart Gramo



STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "GRAMO"

Ne baze te ligjit 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te vepritarise private dhe privatizimit" dhe te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare", me vullnetin tone te lire, te shprehur ne nenskrimin e Aktit Themelues (kontrates), ortaket:

1. **Kapllan Gramo**, i biri i Muharremit, Datelindja 1952, lindur e banues ne Erseke.
2. **Eduart Gramo**, i biri i Shkelqimit, Dtl. 1967, lindur e banues ne Erseke.

Hartojne Statutin e shoqerise si me poshte:

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emertohet "**GRAMO**" sh.p.k.

NENI 2

Selia e shoqerise tregetare private "**GRAMO**" sh.p.k. do te jete ne Erseke.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne regjistrin tregetar, prane Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e:

1. Shfrytezim dhe perpunim te lendes drusore, mbareshtim dhe permiresime te pyjeve.
2. Prodhimin dhe shitjen me shumice e pakice te produkteve dyta te pyllit, si thupra, reshire etj.
3. Sistemimin e pellgjeve, ndertimin e ujembledhesave, sistemim kullota dhe livadhe.
4. Tregetim me shumice e pakice dhe import-eksport te:
 - Mallra industriale, ushqimore, elektro-shtepiake, konfeksione
 - Mallra bujqesore e blegtorale, bime medicinale-mjekesore etj.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise tregetare private "**GRAMO**" sh.p.k. do te jete 100.000 leke, dhe perbehet nga kuota e te dy ortakeve themelues te shoqerise.



- Kuotat e ortakeve te shoqerise ne kapitalin fillestar jane ne proporcione si vijon:
1. **Kapllan Gramo**..... 50 %
 2. **Eduart Gramo**..... 50 %

Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit te ortakeve themelues te shoqerise.

Kuotat e pjesemarrjesve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shese kuotat e tij, teresisht apo pjeserisht, duhet me pare te njoftoje ortakun tjetër te shoqerise.

Ortaku tjetër ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejte ortakut duhet ta ushtroje brenda 30 diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos-ushtimit te se drejtes se blerjes se pare, ortakut qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emrin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favoreshme se sa ato te ofruara ortakut tjetër te shoqerise.

NENI 7

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar, mjetet e xhiros, pasuri te lujtshme ose te palujtshme etj, te nevojeshme per ushtimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 8

Kuotat e kapitalit fillestar jane te derdhura nga çdo ortak ne Banke, ne llogarinet bankare te shoqerise, si edhe te regjistruara ne librin e llogarise te shoqerise.

NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkepunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po keshtu ai fiton edhe te drejtat qe jane krijuar para largimit te tij.

NENI 10

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarise dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakeve, ne proporcion me kapitalin fillestar te derdhur, por kurdohere, pasi te jene shlyer detyrimet ligjore.

NENI 11

Shoqeria tregtare "**GRAMO**" sh.p.k. eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, materiale ose jo-materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjeret.

Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria tregtare "**GRAMO**" sh.p.k. gezon te drejta, sikunder çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



NENI 12

Shoqeria tregtare "**GRAMO**" sh.p.k. vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj.

Ortaket themelues te shoqerise mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet qe ortaket kane patur para se ajo te krijohet.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Organet drejtuese te shoqerise tregtare private "**GRAMO**" sh.p.k. do te jene:

Asambleja e ortakeve

Administratoret

Komisioni i revizionimit

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes se organeve drejtuese do te rregullohen me statut.

Asambleja e shoqerise perbehet nga te dy ortaket themelues. Themeluesit e shoqerise e qeverisin ate duke u mbeshtetur ne te drejten e tyre te prones private te investuar ne kete shoqeri.

Vendimet qe merr asambleja jane te detyrueshme per ortaket e shoqerise. Asambleja thirret sa here e shohin te aresyeshme ortaket themelues te shoqerise, por detyrimisht ne Dhjetor, per te miratuar programin e veprimtarise per vitin e ardhshem dhe ne Mars, per te miratuar bilancin kontabel te vitit te meparshem.

NENI 14

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, caktuar nga ortaket themelues te shoqerise, z.**Kapllan Gramo**.

NENI 15

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme kur te jene pranuar unanimisht nga te dy ortaket themelues te shoqerise.

NENI 16

Hyjne brenda detyrave dhe kopetencave te Asamblese se ortakeve si me poshte:

1. Ndryshimi i aktit te themelimit dhe i statutit te shoqerise.



2. Miratimi i buxhetit vjetor, i raporteve te administrimit, i inventareve dhe i bilancit e llogarise vjetore.
3. Zgjedhja e administratoreve jo-ortake dhe caktimi i detyrave dhe i kopetencave te tyre, me perjashtim te atyre qe shenohen ne statut.
4. Aprovimi i garancive qe ka shoqeria.
5. Miratimi i çmimeve per mallrat qe trajton shoqeria, si dhe tarifave te sherbimeve te saj.
6. Pranimet ne pune dhe largimet nga puna.
7. Caktimi i formes se vules dalluese te shoqerise.
8. Kryerja e te gjitha veprimeve te administrimit te Shoqerise ne emer, per llogari dhe per interes te saj.

NENI 17

Administratori jo ortak perveç detyrave qe i caktojne ortaket e shoqerise ka edhe keto detyra e te drejta:

1. Te mire-administroje pasurine e shoqerise.
2. Te beje marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kopetencave te caktuara nga ortaket.
3. Te zbatoje rregulloren e brendeshme te shoqerise.
4. Te pergjigjet per demet qe i sjell Shoqerise nga veprimet e tij.
5. Te paguhet per punen qe kryen ne baze te marreveshjes te bere me ortaket.
6. Te marre te dhena dhe te beje propozime per gjithçka qe e çmon si te dobishme per shoqerine.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E SHOQERISE

NENI 18

Shoqeria ka te drejte:

1. Te importoje dhe te eksportoje mallra ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj.
2. Te siguroje pasurine e vet.
3. Te marre kredi ne leke dhe ne valute nga bankat vendase dhe te huaja ne baze te rregullave ligjore.
4. Te perfitoje nga favoret qe i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera.
5. Te investoje kudo ne Shqiperi, nga te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj.
6. Te punesoje punetore te thjeshte ose te kualifikuar, vendas ose te huaj.
7. Te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

NENI 19

Shoqeria ka per detyre:

1. Te siguroje kapitalin themeltar ne formen dhe kohen e duhur.



3. Te jape garanci per mallrat qe trajton dhe sherbimet qe kryen.
4. Te siguroje punonjesit e saj.
5. Te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. Te respektoje standartet shteterore si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE TE SHOQERISE

NENI 20

E gjithë veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

NENI 21

Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31. Mars te çdo viti nxirret bilanci.

NENI 22

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

NENI 23

Shoqeria mban xhiro-llogarite ne Banken Kombetare Tregtare Shqiptare. Llogarite mbahen ne leke dhe pasqyrohen ne librat perkatese.

NENI 24

Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, shoqeria, pasi ben zbritjet e humbjeve te vitit te meparshem, le menjane 5 % te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme", deri sa ky fond te arrije ne masen 10 % te kapitalit themeltar.

NENI 25

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondeve te permendura me siper dhe pagimit te detyrimeve fiskale, i mbesin ne perdorim ortakeve te shoqerise.

Fitimi i realizuar nga shoqeria do te ndahet ne mes te ortakeve te saj, ne proporcion me kapitalin e derdhur nga secili ortak.



Ndarja e dividendeve behet sipas menyres dhe ne afatet qe vendos asambleja e shoqerise.

Konvertimi i parase te realizuar nga shitja do te behet sipas kushteve qe do te kete Banka e Shtetit shqiptar, ose Bankat e tjera private dhe transferimi i saj do te behet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

DISPOZITA TE VEÇANTA

NENI 26

Shoqeria ka vulen e vet dalluese.

SHNDRRIMI, SHPERBERJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

NENI 27

Shndrrimi i shoqerise "**GRAMO**" sh.p.k. ne shoqeri te tipeve te tjera, kolektive ose me drejtim te thjeshte, mund te behet me vendim te Asamblese se ortakeve.

NENI 28

Shperberja e shoqerise, mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, si:

- Humbja e kapitalit te shoqerise,
- Pamundesi veprimi,
- Me vendim te asamblese se ortakeve

Ne keto raste, pronaret e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke iu percaktuar edhe detyrat.

Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise per derisa ajo t'u dorezohet personave perkates fizik e juridik, duke likuiduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.

Ne rast se fondet disponibel, rezultojne te pamjaftueshme, per shlyerjen e detyrimeve te shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakeve themelues te shoqerise qe te derdhin teresisht kuotat qe i'u takojne atyre respektivisht.

DISPOZITA TE PERGJITESHME

NENI 29

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, referohen plotesimet qe do te behen nga ortaket themelues, si edhe ligjeve te veçanta te legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen me menyren dhe proceduren me te cilen nxirret vete statuti.


NENI 30

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private "GRAMO" sh.p.k.


ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

" GRAMO " sh.p.k.

Kapllan Gramo



Eduart Gramo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES

Nr.....Rep 1576

Nr.....Kol 379

Tirane me 18.2 1997

VERTETIM

Vertetohet se Statuti i Shoqerise tregtare private "GRAMO" sh.p.k. nenshkrhet prej ortakeve themelues zz. **Kapllan Gramo** dhe **Eduart Gramo**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga leter-njoftimet, ne prezencen time dhe une notere duke e gjetur ate te rregullt e nenshkruaj si me poshte.



Shoqeria "GRAMO" shpk
Me seli ne Erseke

V E N D I M
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
Nr. 1 date 02.04.2003

Sot me daten 02.04.2003 shoqeria "GRAMO" me ortake te saj:
Z.Kapllan Gramo, i biri i Shkelqimit,lindur dhe banues ne Erseke, madhor dhe me
zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Z.Eduart Gramo ,i biri i Shkelqimit,lindur dhe banues ne Erseke,madhore dhe me
zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.16990 date 18.2.1997 eshte
themeluar shoqeria "Gramo" shpk, me ortak te saj z. Kapllan Gramo dhe z.
Eduart Gramo , te cilet te dy sebashku zoterojne 100% te kapitalit i ndare kjo ne
kuota 50% me 50%.

Me vendimin nr. 1 date 02.04.2003 shoqeria

V E N D O S I :

- 1.Transferimin e pjesshem te kuotave te kapitalit me ane te shitjes , duke ja kaluar
z. Llambi Pire 25% dhe Z.Alfred Gramo 25% ,duke u bere keta te fundit,
bashkeortake me kuota te barabarta nga 25% seicili ne shoqerine"GRAMO"shpk.*
- 2.Miratimin e emerimit te administratorit te ri te shoqerise z.Eduart Gramo.*

Perfundimisht kapitali i shoqerise"Gramo" shpk perbehet nga ortaket e saj Z.Kapllan
Gramo,Eduart Gramo, Llambi Pire e Alfred Gramo te cilet zoterojne nga 25% te
kuotave te ketij kapitali.

*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se shkalles se pare Tirane .

**Vendimi i mesiperm merret nga ortaket, bazuar ne nenet perkatese te statutit te
shoqerise, si dhe te Ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"**

ORTAKET E SHOQERISE

KAPLLAN GRAMO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Notere Mimoza Shehu

Nr. 2716 rep.


Nr. 773 kol.

EDUART GRAMO



V E R T E T I M

Sot me daten 8/4/2003, ne zyren e Noterise Tirane,perpara meje
Noteres Mimoza Shehu u paraqiten personalisht ortaket e shoqerise te cilet deklaruan
se sa siper eshte deklarim i vullnetit te tyre e nenshkruan ne pranine time dhe une
noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.



NOTERE

271 25

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA " GRAMO" SHPK



V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Me vendimin nr.16990, date 18.02.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "gramo" shpk me ortak Kapllan Gramo dhe Eduart Gramo, me administrator Kapllan Gramo, me objekt veprimtarie ne fushen e Shrytezimit dhe perpunimit te lendes drusore, mbarshtrimin dhe permiresimin e pyjeve etj.

Me vendimin nr. 1 dt. 02.04.2003 te Asamblese se ortakeve eshte vendosur transferimi I pjesshem te kuotave te kapitalit me ane te shitjes duke ja kaluarz. Llambi Pire 25 % dhe z. Alfred Gramo 25 % duke u bere keta te fundit bashkeortake me kuota te barabarta nga 25 % sejcili ne shoqerine Gramo" sh.p.k. Miratimin e administratorit te ri te shoqerise z. Eduart Gramo".

Duke pare aktivitetin e shoqerise ne ortaket e shoqerise sot me date 20.05.2003 ;

V E N D O S E M :

- A. Studim e projekte te punimeve pyjore.
- 1.Per hartimin e planeve te manaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjyetise sportive e turistike e kullotave.
 - 2.Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve .
 - 3.Hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve per hartimin e projekteve te manaxhimit te pellgjeve e ujembledhes.
 - 4.Per studimin e mbritshmerise dhe ndertimin e rrugeve pyjore.
 - 5.Per studimin fitopatologjik-entomologjike dhe zjarreve ne pyje
- Per studimin e manaxhimit e perdorimit te teritorit. .
Per studimin e rezervave gjenetike, pyjore dhe biodiversitetin.
- Zbatimin e te punimeve pyjore.
- Per pylllezimet (fidanishtet, grumbullimin e trajtimit e farerave pyjore,punime pregatitore e mbjellje fidanesh).
Per permiresimin e pyjeve(licungime e trajtim pyjesh me prerje
- Per hartimin e planeve te manaxhimit te pujeve, flores spontane, gjyetise sportive e turistike dhe kullotave.
Per hartimin e projekteve te pylllezimit.
Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve .

b e qendrueshem te pyjeve , sistemime malore, ndertimin e rrugeve pyjore, grumbullimin dhe vjeljen e qendrueshme te prodhimeve pyjore jo drusore dhe flores spontane, mjeksore e tanifere.

Per ushtrimin e gjuetise sportive turistike te faunes se eger per mbrojtjen nga semundjet demtuesit dhe zjarret.

Perpunime ne kullota, livadhe, dhe ndertimin e meremettimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota dhe livadhe.

Kerkojme te depozitohet vendimi i Asamblese se Ortakeve date 14.03.2002 prane zyres se Regjistrimit Tregtar per t'u bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie.

O R T A K E T

Kapllan Gramo Eduart Gramo

Alfred Gramo Llambi Pire

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE Tirane

Nr. 1592 Rep.

VERTETIM

Vertetojme se sot, me date 21.03.2003, para meje noteres u paraqit kerkuesit Kapllan Gramo Eduart Gramo, Alfred Gramo dhe Llambi Pire per identitetin e te cileve pasi u sigurova nga leternjoftimi perkates, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se sa me siper u be me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noteres, dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 277 Rep

Nr. 779 Kol



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me daten 8/4 /2003 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje **Noteres Mimoza Shehu** u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte me cilesine e shitesit dhe te bleresave te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare" kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

SHITESIT: Z.Kapllan Gramo, i biri i Muharremit, dtl.1951, lindur dhe banues ne Erseke ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta e tij me Nr.1053181

Z.Eduart Gramo, i biri i Shkelqimit, dtl.1967, lindur dhe banues ne Erseke ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta e tij me Nr.1511063.

DHE

BLERESIT: Z.Llambi Pire, i biri i Shkelqimit, dtl.1969, lindur dhe banues ne Erseke, madhor dhe me zotesi juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me Nr.1189705

Z.Alfred Gramo, i biri i Shkelqimit, dtl.1978, lindur dhe banues ne Erseke, lindur dhe banues ne Erseke ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me Nr.1510141

OBJEKT: Transferimin e kuotave te shoqerise "GRAMO" shpk qe i perkasin Z.Kapllan Gramo dhe Eduart Gramo ne mbeshtetje te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" neneve 62,63 dhe neneve te Statutit te shoqerise tregtare "**Gramo**" shpk.

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te shoqerise "**Gramo**" shpk, shoqeri kjo e regjistruar si person juridik me vendim te Gjykates se rrethit Tirane me nr.16990 date 18.2.1997.

Ortakët e shoqerise "GRAMO" shpk zoterojne z. Kapllan Gramo 50% te kapitalit te shoqerise dhe Z.Eduart Gramo zoteron po 50% te kapitalit te shoqerise

Ne mbeshtetje te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" nenit 62,63 dhe neneve perkates te Statutit te shoqerise tregtare "**Gramo**" shpk shitesit dhe bleresit bien dakort midis tyre per shitblerjen e kuotave si me poshte vijon:

I) Shitjen e pjesshme te pjeseve te kapitalit te shoqerise me menyren si vijon:

Z.Kapllan Gramo i cili aktualisht zoteron 50% te kapitalit i shet: Z.Llambi Pire 25% te kapitalit kundrejt shumes 50.000(pesedhjete mije) leke, i cili deklarlon se eshte dakort ti bleje ato.

Z.Eduart Gramo i cili aktualisht zoteron 50% te kapitalit i shet: Z.Alfred Gramo 25% te kapitalit kundrejt shumes 50.000(pesedhjete mije) leke, i cili deklarlon se eshte dakort ti bleje ato.

Perfundimisht kapitali i shoqerise "Gramo" shpk do te perbehet nga:

Perfundimisht kapitali i shoqerise "Gramo" shpk perbehet nga ortakët e saj Z.Kapllan Gramo, Eduart Gramo, Llambi Pire e Alfred Gramo te cilet zoterojne nga 25% te kuotave te ketij kapitali, te cilet marrin persiper nga ky moment gjithë te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i kesaj shoqerie.

Sa siper te dy palet deklarojne ne prani te noteres se jane dakort per shitblerjen e kuotave ne menyren e pershkruar me siper.

Kontrata si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruhet vullnetarisht ne prani te noteres nga shitesit dhe bleresit dhe une noterja legalizoj nenshkrimet sipas figjit.

Kontrata u redaktua ne pese kopje me fuqi te barabarte secila,ku njera prej tyre arkivohet ne kete zyre noteriale.

SHITESIT

KAPLLAN GRAMO

Kapllan Gramo

EDUART GRAMO

Eduart Gramo

Buzo

BLERESIT

LLAMBI PIRE

Llambi Pire

ALFRED GRAMO

Alfred Gramo



K R E R K E S E

KERKUESI : Eduart Gramo, administratori I Shoqerise "Gramo" sh.p.k. banues ne ne Erseke.

OBJEKT : Depozitimi i vendimit te Asamblese se ortakeve te dates 20.05.2003 te shoqerise "GRAMO" shpk per shtese objekti.

PERPARA GJYKATES SE Shkalles se Pare

T I R A N E

Me vendimin nr.16990, date 18.02.1997 eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "GRAMO" shpk me ortak Eduart, Alfred dhe Kapllan Gramo, me administrator Eduart Gramo, me objekt veprimtarie ne fushen e shrytezimit dhe perpunim te lendes drusore, mbarshtrim dhe permiresim te pyjeve etj.

Me vendimin nr.1 dt..20.05.2003te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie eshte vendosur te shtoje objektin edhe ne fushen e

Studime e projektme te punimeve pyjore.

Per hartimin e planeve te manaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjyetise sportive e turistike dhe kullotave.

Per hartimin e projekteve te pyllezimit.

Per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve .

Q Per hartimin e projekteve te shrytezimit te qendrushem te pyjeve dhe projekte te menaxhimit te pelligjeve ujembledhes.

Per studimin e mbritshmerise dhe ndertimin e rrugeve pyjore, fitopatologjike-entomologjike dhe zjarreve ne pyje, studimin, e manaxhmit e perdorimit

PULLE TAKSE

100
LEKE

RISHQIPERISE

22 M
92 05 2003
M. Doggo

Per depozitimin
Kerkese
Vendimin asamblese
te ortakeve
dt. 20/5/2003

28.5.2003

M. Doggo

te teritorit per studimin e rrezervave gjenetike, pyjore dhe biodiversitetin.

B. zbatimin e punimeve pyjore,,

QPer pyllezime-(fidanishtet, grumbullimin e trajtimin e farerave pyjore,punime pregatitore e mbjellje fidanesh).

Per permiresimin e pyjeve(licungime e trajtim pyjesh me prerje kulturore).

Per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve , sistemime malore, ndertimin e rrugeve pyjore, grumbullimin dhe vjeljen e qendrueshme te prodhimeve pyjore jo drusore dhe flores spontane, mjeksore e tanifere.

Per ushtrimin e gjuetise sportive turistike te faunes se eger per mbrojtjen nga semundjet demtuesit dhe zjarret.

Perpunime ne kullota, livadhe, dhe ndertimin e meremettimin e veprave per sigurimin e ujit te pishem ne kullota dhe livadhe.

Kerkoj te depozitohet vendimi i Asamblese se Ortakeve date 14.03.2002 prane zyres se Regjistrimit Tregtar per t'u bere ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie.

KERKUESI
Eduar Gramo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR. 1591 Rep.

V E R T E T I M

Vertetohet se me 22.03.2002 para meje noterese u paraqit kerkuesi Kapllan Gramo per identitetin e te cilit pasi u sigurova, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se kerkesa e mesiperme eshte bere me vullnetin e saj te lire dhe te plote dhe nenshkroi para meje noterese dhe une noterja e vertetoj sipas ligji.

NOTERIA
TIRANE

16990/1
18/04/2003

3 B
16 APR
16 04 2003
Administratori i saj

K E R K E S E

KERKUES: Shoqeria "Gramo" shpk e perfaqesuar nga Administratori i saj Z.Kapllan Gramo, i biri i Muharremit, dtl.1951, lindur dhe banues ne Erseke, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

OBJEKT: Depozitimim e dokumentave te shoqerise "GRAMO" shpk ne mbeshtetje te Ligjit 7667 dt. 28 janar 1993.

PERPARA: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

T I R A N E

Me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.16990 date 18.2.1997 eshte themeluar shoqeria "GRAMO" shpk.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaket e shoqerise kane vendosur :

- 1. Transferimin e pjesshem te kuotave te kapitalit me ane te shitjes , duke ja kaluar z. Llambi Pire 25% dhe Z.Alfred Gramo 25% ,duke u bere keta te fundit, bashkeortake me kuota te barabarta nga 25% seicili ne shoqerine "GRAMO" shpk.
- 2. Miratimi i emerimit te administratorit te ri te shoqerise z. Eduart Gramo.

Sa siper i kerkoj Gjykates:

Te pranohet kerkesen per depozitimim ne Regjistrin Tregtar te vendimit te ortakeve te shoqerise "GRAMO" shpk.

Bashkelidhur kerkeses jane:

- 1. Vendimi i Ortakeve te Shoqerise
- 2. Kontrata e shitjes se kuotave

Bi depozi... 17.04.03


K E R K U E S I
Administrator i Shoqerise
Kapllan Gramo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Notere Mimoza Shehu
Nr. 2043 rep.

1. Vendimi Nr 1 dt 02.04.03 i Asambleses se Ortakeve
2. Kontrate shitje kuotave Nr 2717/777 dt 08.04.03

V E R T E T I M

Sot me daten 07/04/2003, ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje Noteres Mimoza Shehu u paraqit personalisht Z.Kapllan Gramo , me identitetin sa siper, i cili deklaroi se sa siper ehte deklarim i vullnetit te tij e nenshkroi kerkesen ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimin sipas ligjit.



BANKA TREGËTARE AGRARE

DEGA KOLONJË

Ersekë, më 05.01. 1997

V È R T E T I M

Vërtetojmë se Z. Kapllan Gramo ka gjëndje në llogarinë
likujduse shumë lek 100.000 (njëqindmijë lekë)

E lëshojmë këtë vërtetim sipas kërkesës së tij .

D R E J T O R I

(Dashmir





K E R K E S E

KERKUESIT: 1. **Kapllan Gramo**, i biri i Muharremit, Dtl. 1952, lindur e banues ne Erseke.
2. **Eduart Gramo**, i biri i Shkelqimit, Dtl. 1967, lindur e banues ne Erseke.

OBJEKTI: Rregjistrimin e personit juridik ne baze te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 dhe te ligjit Nr.7512 date 10.08.1991.

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Ne kerkuesit, **Kapllan Gramo**, i biri i Muharremit, Dtl. 1965, lindur e banues ne Erseke dhe **Eduart Gramo**, i biri i Shkelqimit, Dtl. 1965, lindur e banues ne Erseke, kerkojme te regjistrohemi si person juridik i shoqerise tregtare private "**GRAMO**" sh.p.k, per te ushtruar aktivitet privat ne fushen e:

1. Shfrytezim dhe perpunim te lendes drusore, mbareshtim dhe permiresime te pyjeve.
2. Prodhimin dhe shitjen me shumice e pakice te produkteve dyta te pyllit, si thupra, reshire etj.
3. Sistemimin e pellgjeve, ndertimin e ujembledhesave, sistemim kullota dhe livadhe.
4. Tregetim me shumice e pakice dhe import-eksport te:
 - Mallra industriale, ushqimore, elektro-shtepiake, konfeksione
 - Mallra bujqesore e blegtorale, bime medicinale-mjekesore etj.

Administrator i shoqerise do te jete z.**Kapllan Gramo**.
Kapitali fillestar eshte 100.000 leke.
Kohezgjatja mbi 10 vjet.
Selia e shoqerise do te jete ne Erseke.
Mbetemi me shprese se kerkesa jone do te merret parasysh.

Bo megr...
18.02.97
[Signature]

KERKUESIT

Kapllan Gramo

[Signature]

Eduart Gramo

[Signature]

REPUBLIKA E SHQPERISE
NOTERIA E TIRANES

Nr.....Rep 1576
Nr.....Kol 371

Tirane me 18.2 1997

VERTETIM

Vertetohet se kerkesa e Shoqerise tregtare private "**GRAMO**" sh.p.k. nenshkruhet prej ortakeve themelues zz. **Kapllan Gramo** dhe **Eduart Gramo**, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga leter-njofitimet, ne prezencen time dhe une notere duke e gjetur ate te rregullt e nenshkruaj si me poshte.



NOTERE
[Signature]